



## Procesverbali i Kuvendit Vjetor të Platformës CiviKos 2015

16 Dhjetor 2015, 12:00 – 15:00

“Hotel Sirius” Prishtinë

### Rendi i ditës

<b>12:00 – 12:30</b>	Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe shpërndarja e materialit të Kuvendit
<b>12:30 - 12:35</b>	Hapja dhe fjala e mirëseardhjes  Taulant Hoxha, Kryesues i Bordit, Platforma CiviKos
<b>12:35 - 12:45</b>	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit
<b>12:45 – 13:00</b>	Prezantimi i raportit të punës dhe raportit financiar për periudhën në mes të dy Kuvendeve  Valdete Idrizi, Drejtore Ekzekutive dhe Zana Peci, Menaxhere Financiare
<b>13:00 – 13:20</b>	Prezantimi i ndryshimit në Statut  Taulant Hoxha, Kryesues i Bordit
<b>13:20 – 13:35</b>	Diskutime
<b>13:35 – 13:45</b>	Votimi i dokumenteve dhe ndryshimeve
<b>13:45 – 14:00</b>	Zgjedhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Votimit (3 persona)
<b>14:00 – 14:20</b>	Votimi për anëtarë të Bordit dhe numërimi
<b>14:20 – 14:30</b>	Prezantimi i planit të punës për vitin 2016  Valdete Idrizi, Drejtore Ekzekutive
<b>14:30</b>	Mbyllja e Kuvendit dhe dreka

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*

**Vendimet e Kuvendit të Platformës CiviKos gjatë punës së Kuvendit:**

**Vendim 1:** Visar Sutaj (KDI) caktohet si Kryesues i Kuvendit të CiviKos.

**Vendim 2 :** Miratohet pagesa e anëtarësisë në CiviKos, që do të jetë shumë fikse.

**Vendim 3:** Me 82 vota pro miratohet ndryshimi i Nenit 6.10 të Statutit të CiviKos.

**Vendim 4 :** Miratohet Neni i 10 i Statutit të CiviKos me 54 vota pro ku Pagesa e anëtarësisë në CiviKos të jetë shumë fikse.

**Vendim 5:** Miratohet me 33 vota pro për pagesë të anëtarësisë opsioni për shumë fikse prej 15 euro.

**Vendim 6 :** Miratohet Raporti i punës i Platformës CiviKos për vitin 2015 si dhe plani i punës për vitin 2016 me asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim.

**Numërimi i votave për një anëtar të ri të bordit të CiviKos:** Anëtarja e re e Bordit të CiviKos zgjidhet Ariana Qosaj Mustafa nga organizata KIPRED me gjithsej 46 vota.

---

**Procesverbali më gjerësisht**

12:30 - Kryesuesi i Bordit të Platformës CiviKos - Taulant Hoxha hap takimin e Kuvendit të Platformës me fjalë mirëseardhëse për të gjithë pjesëmarrësit. Takimi fillon me arsyetimin e propozim ndryshimeve në Statutin e CiviKos ku njëra ndër arsytet është edhe mos plotësimi i kuorumit në Kuvend të Anëtarëve, mungesë e cila po e bllokoi punën e Kuvendit.

**Pasi ende nuk është plotësuar kuorumi<sup>1</sup> ka dy propozime :**

**Opsioni 1 - Votimi Elektronik-** Propozimi që në Janar 2016 të shkojmë me votim elektronik, për të gjithë anëtarët

**Opsioni 2 -** Organizatat që janë prezentë do të votojnë këtu, ndërsa ato që e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në Kuvend të ju mundësohet votimi elektronik pas Kuvendit.

Nga të pranishmit votohet që të shkohet me opsionin 2, që Kuvendi të vazhdojë me punën e rregullt kurse kuorumi për votim të arrihet përmes votimit elektronik.

---

<sup>1</sup> Statuti i Platformës CiviKos, Neni 7.1.

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*



**Propozim:** Të përcaktohet kryesuesi i Kuvendit. Kërkohet nga pjesëmarrësit të propozojnë kandidatët e tyre .

Shpend Emini nga organizata D4D propozon zt.Visar Sutaj nga KDI. Nuk ka kundërshtime dhe propozime tjera nga pjesëmarrësit .

**Vendim:** Visar Sutaj caktohet si Kryesues i Kuvendit të CiviKos.

**Visar Sutaj** - Prezanton rendin e ditës ku tregon se do të bëhet plotësim ndryshimi i Statutit të CiviKos me dy nene ku kërkon nga pjesëmarrësit ti shikojnë propozim ndryshime të cilat i kanë në formë të printuar. Po ashtu tregon se do të zgjidhet anëtar i ri i Bordit të CiviKos i cili do të zëvendësoj vendin e lirë të zt. Hilmi Jashari i cili është larguar pasi është zgjedhur avokat i popullit.

**13:00-** Pas prezantimit të rendit të ditës ftohet znj. Valdete Idrizi- Drejtore Ekzekutive e Platformës CiviKos të prezantoj raportin në mes dy Kuvendeve.

**Valdete Idrizi**- fillon prezantimin e raportit duke theksuar sfidat në koordinim të shoqërisë civile dhe qeverisë për të arritur një dialog të strukturuar. Ndonëse është bërë shumë punë në implementim të Strategjisë, ende mbetet për t'u dëshiruar implementimi i plotë i Strategjisë Qeveritare.

**Znj. Idrizi prezanton :**

- **Aktivitetet rreth implementimit të Strategjisë së Platformës CiviKos 2015 – 2017**
  - Objektiva strategjike 1:Fuqizimin e marrëdhënieve me organizatat anëtare dhe jo-anëtare të Platformës CiviKos si dhe portfolio e zgjeruar e shërbimeve
  - Objektiva strategjike 2: Koordinimi i shoqërisë civile për zbatimin e strategjisë
  - Objektiva strategjike 3: Zhvillimi i dialogut të strukturuar mes shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike
- **Aktivitete rreth implementimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, për katër objektivat strategjike.**
- **Aktivitetet tjera të rregullta të Sekretariatit të Platformës CiviKos**
  - Fuqizimi i marrëdhënieve me organizata anëtare dhe jo anëtare
  - Shërbimi Informues për anëtarë i Platformës CiviKos
  - Aktivitetet e Sekretariatit të CiviKos
  - Implementimi i Rregullores së Punës dhe Kodit Etik

Pas përfundimit të raportit në mes dy Kuvendeve Znj. Idrizi fton Menaxheren Financiare të CiviKos Zana Peci për të prezantuar raportin financiar.

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*

**13:40-** Menaxherja e Financave në Platformën CiviKos Zana Peci prezanton Raportin Financiar për vitin 2015. Nuk ka pyetje dhe sugjerime nga të pranishmit. Te dy raportet u miratuan pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

**13:45- Visar Sutaj-** Pasi nuk ka pyetje dhe komente për Raportin Narrativ dhe atë Financiar për vitin 2015, e fton zt. Taulant Hoxha të propozojë ndryshimet në Statutin e Platformës CiviKos.

Taulant Hoxha propozon ndryshimet në Statut: NENI 6.10

**(Teksti i ri i propozuar) 6.10.** *Përrjashtimisht nga paragrafi 8 i këtij neni, një organizatë anëtare e CiviKos përjashtohet nga CiviKos për shkak të pasivitetit, në rastet e mëposhtme:*

- 1. Në rast se nuk merr pjesë në dy (2) Kuvende të Anëtarëve të njëpasnjëshme; ose*
- 2. Në rast se nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të CiviKos për një periudhë 24 mujore, e cila dëshkohet nëpërmjet listave të pjesëmarrësve të aktiviteteve të CiviKos*
- 3. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasive të CiviKos sipas nënparagrafit 1 të këtij paragrafi niset nga Drejtori Ekzektiv i CiviKos, pas fillimit të punimeve të Kuvendit të Anëtarëve, si pikë e parë e Rendit të Ditës të takimit të Kuvendit të Anëtarëve.*
- 4. Procedurës së përjashtimit të anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi i paraprin procedura e suspendimit, e cila aplikohet në rast se organizata anëtare nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të CiviKos për një periudhë 12 mujore. Suspendimi zbatohet bazuar në procedurat e njëjta me ato të përjashtimit.*
- 5. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi niset nga Sekretariati i CiviKos në rast se organizata e suspenduar vazhdon të mbetet pasive edhe gjatë 12 muajve vijues pas suspendimit. Kjo procedurë konfirmohet nga Bordi dhe aprovohet nga Kuvendi , si pikë e parë e Rendit të Ditës së takimit të radhës.*
- 6. Anëtarët pasiv të cilët suspendohen ose përjashtohen me vendim të Kuvendit nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit për Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos në të cilën këta anëtarë përjashtohen.*
- 7. Në momentin e nisjes së procedurës së suspendimit ose përjashtimit sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi, por jo më pak se shtatë (7) ditë para mbajtjes së Kuvendit të Anëtarëve, Sekretariati i CiviKos obligohet që organizatat anëtare ndaj të cilave fillohet procedura e suspendimit ose përjashtimit t'i njoftojë për këtë procedurë, në e-mailin zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar. Njoftimi duhet të përmbajë arsyen e nisjes së procedurës së suspendimit ose përjashtimit, së bashku me të drejtën e organizatës anëtare që të dëshmojë aktivitetin e saj.*
- 8. Procedura e suspendimit ose përjashtimit të një organizate pasive sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi mund të ndërpritet vetëm në rast që organizata anëtare ofron dëshmi të mjaftueshme për*  
*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*

aktivitetin e saj në kuadër të CiviKos. Për një veprim të tillë, Drejtori Ekzekutiv i CiviKos njofton Kuvendin e 5 Anëtarëve, duke kërkuar ndërprerjen e procedurës së suspendimit ose përjashtimit të organizatës anëtare.

### **Propozimi për Nen të ri**

#### **(Teksti i ri i propozuar) Neni XX – Pagesa e Anëtarësisë**

1. Organizatat anëtare të CiviKos obligohen që të paguajnë anëtarësinë në Platformën CiviKos, në një shumë e cila përcaktohen nga Kuvendi i Anëtarëve. Shuma e tarifës së anëtarësimin është e barabartë për të gjitha organizatat anëtare, pavarësisht statusit të tyre financiar apo ndonjë statusi tjetër.

2. Pagesa e anëtarësisë bëhet në baza vjetore në fillim të çdo viti kalendarik, por jo më vonë se në datën 15 mars të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë. Dështimi për të paguar tarifën e anëtarësisë brenda këtij afati sjell përjashtimin automatik të organizatës anëtare nga CiviKos.

3. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi niset nga Sekretariati i CiviKos, konfirmohet nga Bordi dhe aprovohet nga Kuvendi , si pikë e parë e Rendit të Ditës së takimit të radhës.

4. Organizatat anëtare të cilat përjashtohen me vendim të Kuvendit nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit për Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos në të cilën këta anëtarë përjashtohen.

5. Jo më vonë se më 1 mars të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë, Sekretariati i CiviKos obligohet që organizatat anëtare të cilat nuk e kanë bërë pagesën e anëtarësisë t'i njoftojë për obligimin e tyre, në e-mailin zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar. Njoftimi duhet të përmbajë kërkesën për pagesë brenda afatit të paraparë dhe njoftimin rreth përjashtimit automatik në rast të mos-pagesës brenda afatit të paraparë.

6. Procedura e përjashtimit automatik të një organizate anëtare mund të ndërpritet vetëm në rast që organizata anëtare dëshmon që për arsye jashtë kontrollit të saj (vis-major) nuk ka qenë në gjendje që ta bëjë pagesën e anëtarësisë brenda 6 afatit të paraparë, dhe e bën pagesën e plotë të anëtarësisë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbajtjes së Kuvendit të Anëtarëve të radhës. Për një veprim të tillë, Drejtori Ekzekutiv i CiviKos njofton Kuvendin e Anëtarëve, duke kërkuar anulimin e përjashtimit automatik të organizatës anëtare.

**Visar Sutaj**- Fton të pranishmit që të diskutojnë propozim ndryshimet në Statut të CiviKos.

**Shemsi Jashari nga Iniciativa për Ide dhe Alternativa** - Disa organizata nuk mund të paguajnë, dhe pyetja është se a do të suspendohen organizatat që paguan por nuk merr pjesë në aktivitete të CiviKos.

**Florina Duli nga IKS**- Si përkufizohet pasiviteti në CiviKos?

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*

**Taulant Hoxha**- Opsion 1- Nëse nuk merr pjesë në dy Kuvende të njëpasnjëshme.

**Opsion 2**- Nëse nuk merr pjesë në asnjë aktivitet gjatë një viti ku suspendimi mund të bëhet pas 12 muajve, ndërsa përjashtimi pas 24 muajve.

**Arber Kadriu nga INPO**- Në rast të mos pagesës a do të suspendohet organizata sepse u përmend që të përjashtohet automatikisht.

**Mentor Seferi- Programi Për të Drejtat Civile**- Mënyra si do vërtetohet pasiviteti brenda 12 muajve?

**Taulant Hoxha**- Sekretariati është i obliguar të thërret të gjitha organizatat në takime. Mekanizmi për kontrollim janë listat e pjesëmarrjes, të cilat sekretariati i mban rregullisht për çdo aktivitet.

**Rinor Gashi nga Handikos**- Një hap i duhur është pagesa e anëtarësisë. A do krijohet një Rregullore për mjetet nga anëtarësia se si do të shfrytëzohen?

**Taulant Hoxha**- Ne mund të propozojmë që të bëhet një Rregullore, deri në Kuvendin e ardhshëm .

**Propozim 1**- Të bëhet një filtrim dhe pagesa e anëtarësisë të bëhet varësisht nga qarkullimi, psh organizatat që kanë qarkullim 50 mijë euro të paguajnë 5 euro, 100 mijë 10 euro, dhe 1 milion e mbi të jetë 100 euro.

**Propozim 2**: Të jetë pagesa vullnetare ku tregohet pasiviteti dhe kush dëshiron të jetë aktiv.

**Luljeta Demolli nga QKSGJ**- Si organizatë paguajmë antarësi në 3 organizata anëtare. Përshkallëzimi nuk është në rregull dhe propozoj që të ketë tarife fikse. Plani strategjik kushton, si dhe ekspertët kështu që kjo pagesë i mundëson delegimin e mjeteve në këta akterë.

**Shkumbin Arifi nga SHL Kosova**- Suspendimi mbi mos pjesëmarrje. Mungesa e kuorumit mund të hiqet. Nuk ka ligj për rrjete. Ne duhet të largojmë kuorumin.

**Bujar Kadriu nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës**- Propozimet janë për funksionalitet, dhe këto propozime nuk janë për të krijuar burokraci.

**Valon Xhabali nga Ec Ma Ndryshe**-Jo të gjithë anëtarët mund të marrin pjesë në takime të CiviKos atëherë kur CiviKos organizon takime. Propozoj që të jetë pagesa e anëtarësisë si mjet për të qenë anëtarë dhe jo pjesëmarrja.

**Taulant Hoxha** - Kuorumi është obligim ligjor- përshkallëzimi do të shkaktonte vështirësi burokratike.

**Rexhep Gojnovci nga AKTI**- Pagesa e anëtarësisë përcaktohet nga Kuvendi, dhe në nene të statutit vendoset vetëm në vija të trasha, por në Rregullore duhet të vendosen detajet. Për mua do të ishte në rregull pagesa e caktuar 10-15 euro.

**Petrit Tahiri- KEC-** Pagesa fikse do të jetë më e pranueshme. Pritshmëritë të jenë të njëjta. Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes në aktivitete të CiviKos brenda 1 viti dhe 2 viti, edhe Kuvendi i Anëtareve është aktivitet i CiviKos, ku edhe pjesëmarrja në Kuvend njihet si pjesëmarrje në aktivitete të CiviKos.

**Valire Buza nga OJQ LIRA-** Propozoj pagesën fikse për anëtarësi .

**Votohet se a duhet të ketë shkallëzim të pagesës**

Të ketë shkallëzim të pagesës varësisht nga qarkullimi - 3 vota pro

Pagesa në formë vullnetare – 4 vota pro

Formë e pagesës fikse pa shumë te caktuar- 54 vota pro

**Vendim: Miratohet Neni i 10 i Statutit të CiviKos me 54 vota pro ku pagesa e anëtarësisë në CiviKos të jetë shumë fikse.**

**Propozim për votim :** Të votohet shuma e pagesës së anëtarësisë:

**Opsionet për shumën fikse:** 15 euro dhe 20 euro.

**Opsioni 2-** Pagesë vullnetare

**Votimi në Sallë:**

**Pagese fikse 15 euro-** 30 vota pro,

**Pagese fikse 20 euro-** 24 vota ,

**Pagesë Vullnetare-** Asnjë votë.

**Abstenim-** 23

**Votimi Elektronik-** Pagesë fikse 15-euro- 3 vota, Pagesë fikse 20 euro- 2 vota dhe Pagesë Vullnetare- 2 vota .

**Vendim- Miratohet me 33 vota për pagesë të anëtarësisë shuma fikse prej 15 euro.**

**Florina Duli IKS-** Problemi i mos pjesëmarrjes në Kuvend të diskutohet më shumë, si dhe shumat e pagesës te diskutohen më shumë. Nuk u përkufizua qartë pasiviteti i organizatave në CiviKos. Për mua është mos pjesëmarrja në Kuvend pasivitet.

**Taulant Hoxha-** Afati për pagesë të jetë me 15 prill.

**Vendim:** Të përgatitet Rregullorja e CiviKos ku statuti do të pastrohet nga detajet.



**Propozim për votim:** Ndryshimi i nenit 6.10.

**Votimi:** 75 pro, 2 abstenim, dhe kundër asnjë. Miratohet neni 6.10.

**Votimi elektronik:** 7 vota pro dhe asnjë kundër.

**Vendim- Me 82 vota pro miratohet ndryshimi i Nenit 6.10 të Statutit të CiviKos.**

**Vendim- Miratohet Raporti i punës i Platformës CiviKos me asnjë votë kundër dhe abstenim.**

Propozohet të votohet për një anëtar të ri bordit të CiviKos.

Kandidatët e nominuar janë:

	Emri dhe mbiemri	Organizata
1	Ariana Qosaj - Mustafa	KIPRED
2	Besart Hyseni	OJQ "Horizonti 21"
3	Drita Rexhepi	OJQ Kori i Grave "Lira"
4	Edona Tolaj	YIHR KS
5	Mirlinda Sada	MEDICA Gjakova
6	Sevdije Musliu	OJQ PEA (Psikoterapeutët në veprim)
7	Tahire Gashi	OJQ Zana
8	Vehbi Goxhuli	OJQ Gjeomjedisi

Formohet komisioni për numërim të votave i përbërë nga Veton Kryeziu nga The Ideas Partnership, Shpend Emini nga D4D, Agnesa Qerimi nga KYC si dhe Visar Sutaj nga KDI.

Përfundon votimit, ku të gjithë anëtarët prezent hedhin votën e tyre në kutinë e votimit.

**Diskutim:** A duhet të numërohen tani votat?

**Florina Duli-** Propozim- Disa vota i presim në formë elektronike. Pas votave elektronike të numërohen të gjitha votat.

Nëse ka vota të barabarta anëtari i bordit përcaktohet me short.

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*





**Sugjerim:** Data 15 Janar 2016 të jetë data e fundit kur përmbillet votimi elektronik. Votimi mund të bëhet në formë elektronike dhe në kuti të votimit në zyre të CiviKos.

Hapi i radhës është që anëtarët që nuk kanë qenë pjesë në Kuvend të ju dërgohet ftesë për votim elektronik.

**Sugjerim** – Votimi të bëhet me postë?

**Taulant Hoxha-** Mund të votohet në kuti dhe me postë?

**Urim Xharavina Let's Do it Peja-** Të shkojmë vetëm me votim elektronik.

**Visar Sutaj-** Të mbyllet kutia, dhe të votohet vetëm në kuti, deri me 15 Janar 2016 ku hapet kutia në prezencë të komisionit dhe anëtarëve tjerë që dëshirojnë të marrin pjesë.

**Vendim-** Të votohet vetëm në kuti në zyret e CiviKos për anëtar të ri të Bordit, ndërsa ndryshimet në statut në formë elektronike.

Valdete Idrizi prezanton planin e punës për 2016, i cili më pas u votua nga të gjithë të pranishmit, pa asnjë votë kundër apo abstenim.

Mbyllet Kuvendi në ora 15:06.

### **Numërimi i votave për përzgjedhjen e anëtarit të ri të bordit të Platformës CiviKos**

Platforma CiviKos pas mbylljes së procesit të votimit për një anëtarë të ri të Bordit të Platformës CiviKos, me datë 20.01.2016 organizoi numërimin e votave në prani të vëzhguesve në zyret e Platformës CiviKos.

Në mënyrë që procesi i numërimin të votave të jetë sa më transparent, Platforma CiviKos ka ftuar në cilësinë e vëzhguesve të gjitha organizatat anëtarë të Platformës CiviKos.

Përveç Sekretariatit të Platformës CiviKos, në cilësinë e vëzhguesve gjatë numërimin të votave ishin prezent : **Gent Gjilkolli**- KIPRED, , **Visar Sutaj** – KDI kryesuesi i Kuvendit të Platformës CiviKos për vitin 2015 dhe tre vëzhgues të përcaktuar në Kuvendin e Platformës CiviKos: **Agnesa Qerimi** – KYC, **Veton Kryeziu** – The Ideas Partnership dhe **Ferid Murseli** – D4D (zëvendëson Shpend Eminin) .

Gjatë këtij procesi u numëruan të gjitha votat, prej të cilave të gjitha ishin të vlefshme. Gjithsej ishin 84 votues. Pas numërimin të votave me gjithsej 46 vota anëtare e re e Bordit të CiviKos zgjidhet Ariana Qosaj Mustafa me gjithsej 46 vota. Nga numërimi i votave kandidatët tjerë kishin këto vota:

Besart Hyseni- 3 vota, Drita Rexhepi- 8 vota, Edona Tolaj 10 vota, Mirlinda Sada 6 vota, Sevdije Musliu 2 vota, Tahire Gashi 3 vota, si dhe Vehbi Goxhuli 6 vota.

*Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin dhe avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës*